

92
—
5 20



VEHBI ÇANGA

DJALOSHI

ME KEMISHË TE KUÇE

92

520

VEHBI ÇANGA

92

S

DJALOSHI
ME KËMISHË TË KUQE


(Jeta dhe veprimtaria e dëshmorit
Manush Alimani)

23827

ZEBITET 7

SHKURTUESI E SHIFRAT
BIBLIOTEKË

SHTËPIA BOTON L. NAIM FRASHËRI



Manush Alimani në Shkodër në vitin 1943

«Po ju shkruaj nga qelia e Gestapos për herën e fundit. Jam mjaft i ligështuem. Dhetë ditë tortura, tri ditë e natë pa ngrënë e kanë lodhë trupin tim. Por qëndroj nëtë moralisht. Jemi para fitores, prandaj mos u dishproni. Këtu që të gjithë më thërrasin «kriminel». Ka tepër pak shpresa për mua. Qëndrimi i em përpara vdekjes do të jetë: Rroftë Lëvizja Nacional-Çlirimtare! Rroftë Partia Komuniste Shqiptare!
Ju vijoni punën me kujdes dhe përgatituni për hakmarrjen popullore». 1)

VDEKJE FASHIZMIT — LIRI POPULLIT!
MALI

1) Letra e Manush Alimanit, dërgue nga qelia e Gestapos, shokëve të Komitetit Qarkor të Shkodrës.

KUR TRANDAFILAT E LULE-VILET . .

«Shkodra, dashunorja e shekujve! Shkodra, Shkodra, dashunorja e qiellit të kaltër! Shkodra, Shkodra, dashunorja e Maleve të hjedhta, e lumenjve të cemtë e liqenit andërtar. . .» 1)

Shkodra romantike, qyteti i lashtë i artit, i muzikës dhe i këngëve të bukura. Qyteti i Gurakuqit, i Mjedës, i Migjenit. Këtu kundërmojnë lule gjithfarësh dhe lindin trima të vërtetë për çeshtjen e popullit e të atdheut.

«Shkodra, vendi i Vaso Pashës, Vasil Shantos, Perlat Rexhepit, Manush Alimanit, Jordan Misjes, Branko Kadisë, Ndoc Mazit, Naim Gjylbegut, Esat Gjylit, Fahri Ramadanit, Hajrullah Kastratit, Tom Kolës, Salo Halilit, Reshit Rusit, Ahmet Haxhisë, Daniel Matlisë. Shkodra e dëshmorëve të Prishtinës, e Bardhok Bibës, dhe shumë e shumë të tjerëve që dhanë jetën në fushën e nderit për popullin e për atdheun. . .» 2)

1) Migjeni: *Veprat*, Tiranë, 1961, f. 230.

2) Enver Hoxha: *Fjalime...* (15 e 18 shtator 1949), Tiranë, 1949, f. 6.

Një ditë të bukur maji, kur nëpër bahçe e nëpër parqe çelnin lulet shumëgjyreshe, kur luleblini, trandafilat e lule-vilet e mbushin me aromë të kandëshme qytetin tonë, një makinë e zezë u ndal përpara spitalit civil. Nga makina nxuerën me shpejtësi një njeri, që ishte tue dhanë shpirt.

— Doktor!... ky njeri i rrezikshëm nuk duhet të vdesë n'asnjë mënyrë. Ky i din të gjitha strofkat partizane, një të gjithë komunistët e Shkodrës, e nuk thotë asnjë fjalë — foli me egërsi Hauzdingu dhe përpoqi çizmet e tij të randa. Por, as doktori, që erdhi me urgjencë, as britmat e tërbueme të majorit gjerman, nuk mund ta ngjallshin ma atë kufomë mbi të cilën kishin hedhë një kapotë të ndytë ushtarake.

Kjo ndodhi më 29 maj 1944.

Në dhomat e vjetra të një shtëpie shkodrane, të cilën gjermanët e kishin kthye në një burg të tmershëm, si dhe në ndërtesën ku sot asht shtëpia e kulturës e cila, gjatë pushtimit gjerman ka qenë selia e Gestapos, aty, nën shkallën e kësaj të fundit, u torturue deri në vdekje një djalosh që s'i kish mbushë ende të njëzet prandverat, udhëheqësi i rinisë së qarkut, anëtari i Komitetit Qarkor të Partisë, një nga drejtuesit e shquem të Lëvizjes Nacional-Lirimitare për krahinën e Shkodrës, Manush Alimani, i njoftun me pseudonimin MALI.

DRITAT E SHTËPISË NUK U FIKËN DERI NË MËNGJES. . . .

Baba i Manushit, Aliu, ishte lezhjan. Ai lindi në Lezhë, në vitin 1896.

Baba i dëshmorit qe rritë i vetëm. Prindët i vdiqën shumë shpejt. Ai s'kishte as vëlla, as motër. Jetimi e kaloi fëmëninë në Lezhë e në Shkodër. Kur u rrit, me ndihmën e disa kushrive të vet, hapi në qytetin e Lezhës një dyqan me artikuj të përziem, kinkaleri e lojna për fëmijë. Ata që e kanë njoftë tregojnë se baba i Manushit i ka dashtë shumë fëmijët, të cilët grumbulloheshin në dyqanin e tij të vogël, ku blejshin lojna të ndryshme e sidomos kuklla. Ndodhte shpesh herë, që i zoti dyqanit t'ua jepte pa pare kukllat camardhokëve të vegjël që pastaj vrapojshin të gëzuem e tue thirrë me za të naltë: «Kuklla!»! «Kuklla!» Kjo asht arsyeja që lezhjanët e quejshin atë Ali Kuklla.

Në vitin 1922, Aliu u martu me Sabrije Beqir Velajn nga Shkodra. Kjo ishte një grue sa e mirë dhe e bukur, aq e dashun dhe punëtore. Aliu e bani martesën në Shkodër, në lagjen Dudas, por vazhdoi me banue në Lezhë, ku ai kishte dyqanin, me të ardhurat e të cilit siguronte jetesën e përditëshme.

Pa u mbushë dy vjet nga dita e martesës, pikërisht në mbramjen e 8 tetorit 1924, në lagjen Ndocaj të Shkodrës, ku gjindej familja e Aliut dritat e shtëpisë nuk u fikën deri në mëngjes. Ishte një festë e vërtetë familjare. Aliut i leu një djalë i shëndoshë, të cilit i vunë emnin e gjyshit.

Voglushi gëzoi jo vetëm njerëzit e shtëpisë, por edhe fqinjët. Aliut, që posa kishte ardhë me

ngut prej Lezhjet, i shëndritshin sytë prej gëzimit të madh. Ai shëtiste nëpër çardak, pinte duhan pa pushim dhe nganjherë prekte flokët e mustakët e vet të shkurtë. Baba mendonte për djalin e vet dhe për kukllat e shumta që do t'i sillte atij.

J E T I M I

Vitet kaluen me shpejtësi, por nuk vonoi e plasi fatkeqësia. Në fund të vitit 1925 Sabrija e re, pa mbushë 20 vjetët, vdiq, tue e lanë Manushin në djep. Nji pikëllim i thellë e mbuloi shtëpinë. Tash, Aliut iu dhimbt fort Manushi, që ngeli pa nanë dhe po rritej në duert e botës. Shumë plaka të lagjeve të Shkodrës e kujtojnë dhe flasin edhe sot për jetimin e vogël, të cilin shpesh herë e patën mbajtë në krahët e tyne. Kështu, Manushi, që në vitet e para të fëminisë, u gjet në gjiun e popullit të thjeshtë të qytetit ku u lind.

Tek po mbushte tetë vjetët, në kohën kur vëglushi niste klasën e parë të shkollës fillore, vdiq edhe Ali Mani. Tash Manushi mbeti pa babë dhe pa nanë, ashtu si dikur baba i vet.

Revolucionari i ardhshëm u rrit jetim. Ai nuk e njofti fare dashurin e nanës dhe shumë pak përkëdhelime të atnore. Prandaj Manushi i donte aq shumë nanat e shokëve të vet, nanat revolucionare në Tiranë e në Shkodër, ku punoi, por edhe ato e deshën dhe e rruajtën Manushin, porsì djalin e tyne.

Në vitin 1932, mbas vdekjes së prindëve, si kreu klasën e parë të shkollës së Dudasit në Shkodër, Manushin e muer daja i vet në Tiranë. Në Ti-

ranë djaloshi ndoqi shkollën fillore dhe vazhdoi gjimnazin «Naim Frashëri» deri në klasën e shtatë, por kur filloi lufta çlirimtare e ndërpreu, sepse u dërgue në Shkodër, për të punue si udhëheqës i organizatës së rinisë komuniste.

Por në kryeqytet, Manushi kaloi kohën ma të gjatë të rinisë. Këtu ai mori pagëzimin e parë revolucionar.

HARTIMI

Manushi që në vogëli pati disa tipare të bukura dhe po formohej me cilësi të mira qytetare. Njerëzit e families dhe shokët e fëmënisë tregojnë se ishte një djalë pak i mbyllun. Ishte njeri me ndienja të holla, i matun dhe i dashun me shokë. Qysh në vitet e fëmënisë, binte në sv te Manushi pastërtia dhe çiltëria. Ai skuqej kur bisedonte me të tjerët, e sidomos me ma të mëdhajtë.

Në shtëpi, në shkollë e në shoqëni ishte i drejtë, i ndershëm dhe qysh në moshë të re jepte shenjat e një karakteri të qëndrueshëm. Njerëzit që kanë jetue me të tregojnë se po të fillonte një punë, nuk e linte për gjysmë. Po të niste me ba dicka do ta çontë deri në fund. Po ta jepte fjalën e mbante patjetër, edhe sikur të ishte në dam të vet.

Ma vonë, në vitet e luftës për çlirimin e vendit nga pushtuesit fashistë, këto cilësi u zhvilluen ma tej dhe shpërthyen ma me forcë përpara vdekjes së tij heroike. Historikisht ndodhi që pjesa ma e zgjedhun e rinisë sonë u hudh në Luftën Nacional-Çlirimtare. Të rijtë ma të mirë e ma të edukuem e atdhetarë, trima e të vendosun, të rijtë e squet e

guximtarë, pikërisht ata formuen pararojën e brezit të ri gjatë Luftës Nacional-Çlirimtare. Nji prej këtyne të rijve aktivë në Tiranë e ma vonë në Shkodër ka genë Manush Alimani.

Qysh i vogël, që në bangot e shkollës, ai i nderonte njerëzit e thjeshtë e të vorfën. Manushi, megjithëse ishte i ri në moshë, i urrente për vdekje padrejtësitë e atëherëshme. Pushtimi i Shqipnisë nga fashistët italianë, ngjalli ke Manushi urrejtje të madhe për pushtuesit dhe tradhëtarët e atdheut.

Nji nga fisi i familjes së tij në Tiranë tregon:

«Andej nga fundi i prillit të vitit 1939, Manushi pesëmbëdhjetëvjeçar erdhi në shtëpi vonë, i mërzitun e me sy të mbushun me lot. Kur e pyetëm se ç'kishte ndodhë, ai filloi me kja dhe tha: «— Italianët na kanë ndy flamurin me spatat e fashizmit. — Kështu Manushi i ri qëndroi për shumë ditë i zymtë dhe pa folë».

Ashtu si Manushi edhe shumë të rinj të tjerë, bij e bija të popullit të thjeshtë, me ndjenja të nalta patriotike, me urrejtje të madhe për pushtuesin fashist u treguen të gatshëm të bajshin çdo gja për çlirimin e atdheut, prandaj, me formimin e partisë, ata iu përgjigjën thirrjes së saj dhe nuk kursyen as gjënë e tyne ma të shtrenjtë, edhe jetën e banë fli.

Bashkë me shokët e fëminisë e të rinisë: Alqi Kondin, Ramiz Alinë e të tjerë, mbas krijimit të Partisë Komuniste Shqiptare, Manushi u radhit në luftën për vdekjen e fashizmit, për lirinë e popullit, për Shqipninë e lirë, pa shtypje të njeriut prej njeriut.

Në një hartim me temë: «Nji padrejtësi» të shkruem gati një çerek shekulli ma parë, kur ai

ishte nxanës në klasën e shtatë të gjimnazit në Tiranë, Manushi ngrinte me guxim zanin e tij kundër padrejtësive shoqërore dhe mallkonte shfrytëzimin e njeriut prej njeriut:

«Unë këtu nuk besoj që gjithë këto të këqija do t'i kishin ardhë nga pamja e shëmtuet që kishte ajo vajzë, por nga padrejtësinat që ka jeta shoqërore e sotme; ku ka dallim dhe shtypje të njeriut prej njeriut veherë këto padrejtësinat».

Sa herë i lexoj këto rrjeshta më bahet sikur po ndigjoj zanin e paharrueshëm të Manushit dhe habitem me forcën e madhe që kanë idet përparimtare, të cilat përfshinë mendjen dhe zemrën e njerëzve dhe, në radhë të parë, atë të rinisë.



ANËTAR I RINISË KOMUNISTE

Manush Alimani e filloi veprimtarinë revolucionare në Tiranë. Mbas themelimit të organizatës së Rinisë Komuniste Shqiptare, nga fundi i vitit 1941, dhe fillimi i vitit 1942, Manushi u pranue në rininë komuniste, tue ba pjesë në njanin prej aktiveve të rinisë së Gjimnazit të Tiranës. Pranimin në radhët e rinisë, ai e quente një gjë shumë të madhe, prandaj kryente me ndërgjegje çdo vepër që i ngarkohej.

Me punë të vazhdueshme ai fitoi një përvojë të mirë për punën organizative, përvetësoi mjaft njohuri politike dhe shkathtësi për punën ilegale, të cilat e ndihmuen shumë për organizimin e punës në rininë e qarkut të Shkodrës.

Në një shkrim, me titull «Djaloshi me fanelë të kuqe», midis të tjerash shkruhet:

«Shokët e njihnin dhe e donin djaloshin me fanelë të kuqe (Manushin — V. Ç.), sekretarin e aktivitetit të Rinisë Komuniste të klasës VI të Gjimnazit të Tiranës. Ata e donin, se ishte i dashun me të gjithë, e nderonin, se ai sillej mirë me të gjithë. Ish i thjeshtë e punëtor, shok i mirë e luftëtar i guximshëm.

E kush nuk e kish parë atë tek bridhte me biçikletë nga një rrugë në tjetrën për të lajmëruar shokët se në aksh vend, në aksh orë, do të bëhej një mbledhje, ku do të fliste Qemali, ku do të fliste një udhëheqës i rinisë. Ai shkonte nëpër shtëpitë e shokëve, nëpër bazat ilegale, nëpër vendet ku ata punonin, kinse për ndonjë nevojë, e pasi fliste me zë të lartë gjëra pa rëndësi, puliste sytë, që i ndrisnin nga një gëzim i brendshëm, nga një zjarr i pashuar, që digjej përherë në krahorin e tij, shqiptonte qartë, po me zë të ulët: «N'aksh vend, n'aksh orë... pa zhurmë, mos të bjerë armiku n'erë... E kush nuk e dinte se shpesh ai fshihte nën atë fanellën e kuqe të mbyllur gjer në grykë me zinxhir — traktet e partisë, traktet që jepnin anë e mb'anë kushtimin për luftë...»¹⁾

Manushi dallohej si i ri komunist dhe gati gjithë kohën ja kushtonte punës revolucionare. Ai jepte prova besnikie dhe vendosmënie, prandaj

1) Djaloshi me fanellën e kuqe, në Ata rrojnë në zemrat tona, Botim i K.Q. të BRPSH, Tiranë, 1958, 1, ff. 59-66.

Partia e caktoi me një mision të ri, delikat e të randësishëm.

Nji ditë të bukur prilli, kur nxanësit bajshin pushimin në mes orëve të mësimit, n'oborrin plot diell të Gjimnazit të Tiranës, erdhi një korier nga një bazë e partisë. Korieri hyni midis nxanësve dhe me kujdes e me buzëqeshje muer mënjanë Manushin së bashku me një shokun e tij të ngushtë. Ashtu me za të ulët, kinse po bisedonte gjana pa randësi, korieri i njoftoi se i thërriste për takim një nga shokët drejtues të Komitetit Qëndror të Rinisë, që ndodhej ilegal në një shtëpi të vogël të Tiranës.

Të dy studentët u shikuen sy në sy dhe vendosën me shkue në takim. Dhe ashtu vepruen. Ngjijtën me të shpejtë shkallët, hynë në klasë, muerën librat nën sjetull dhe u nisën për në bazën ilegale.

Shoku i K.Q. të Rinisë i priti me përzemërsi, i pyeti shkurt mbi shëndetin, mësimeet dhe hyni menjëherë në temë.

— Do ta lini shkollën — u tha ai, tue i shikue drejt në sy. Ç'të bajsh? Luftë i thonë kësaj. Do të kemi kohë edhe me studjue — dhe buzëqeshi. — Ju të dy do të shkoni me punue me rininë në dy qytete të tjera. Partia ka besim në ju, — përfundoi, dhe tue u shtrëngue dorën u dorëzoi secilit nga një zarf të vogël sekret për Komitetet Qarkore. Atë mbramje, të dy shokët biseduen deri natën vonë për detyrat e mëdha që u delshin përpara, për rrugët e reja plot të paprituna e flijime, si dhe për kujdesin e besimin që tregonte Partia për ta.

Të nesërmen në mëngjes, dy shokët e ngushtë, që duheshin porsì vëllezën, të lidhun që në fëmëni dhe pastaj në shkollë e në aktivin e rinisë, u ndanë me përmallim të madh dhe u nisën në drejtime

të ndryshme. Shoku i tij udhëtoi për në Berat, kurse Manushi u nis për në Shkodër, në vendlindje.

Ishte 12 prilli i vitit 1943.

MANUSHI NE SHKODER

Kur erdhi Manushi nandëmbëdhjetëvjeçar në Shkodër, Lëvizja Nacional-Çlirimtare në qarkun tonë kishte marrë përpjestime të gjana.

Nji anëtar i Komitetit Qendror të Rinisë Komuniste Shqiptare, i cili muer pjesë në mbledhjen e Qarkorit të rinisë, e paraqiti Manushin si nji luftëtar të vendosun për çeshtjen e popullit, që ishte dërgue me punue me rininë e Shkodrës për çlirim e Atdheut. Që nga kjo mbledhje, Manushi filloi punën si sekretar organizativ i Komitetit Qarkor të Rinisë dhe po atë ditë ai u pranue anëtar i Partisë Komuniste Shqiptare.

Kështu pra, që në prill të vitit 1943, Manush Alimani filloi veprimtarinë e tij revolucionare në Shkodër. Problemet e ndërlikueme e plot përgjegjësi të luftës, që kërkojshin guxim, zgjuarësi dhe kambëngulje e burruen shpejt ish gjimnazistin e ri dhe e banë nji udhëheqës dhe organizator të talentuem.

Manush Alimani dallohej për thjeshtësinë dhe aftësinë e tij me u lidhë shpejt me masat. Ai, që në takimin e parë, të linte mbresa e të bante për vehte. Manushi bisedonte me njerëzit, me përzemërsi dhe në mënyrë shoqënore. Ai, megjithëse kishin kalue dhetë vjet që kur ishte largue prej Shkodre, me zotësinë e vet, brenda nji kohe të shkurtën, u njoft e bani për vehte me dhjetra e me qindra miq.

Manushi, së bashku me shokët e tjerë të Qarkorit, me një punë të madhe skjaruese politike me masat, arritën me i shtue edhe ma shumë bazat ilegale, dhe numrin e simpatizantëve të luftës antifashiste nacional-çlirimtare.

Asht vështirë me e tregue dashurinë e madhe dhe simpatinë që kishin për Manushin të gjithë ata që e njifshin në Shkodër. Të panumërta ishin bazat ku strehohej Manushi në Shkodër, dhe kudo pritej me krah hapun dhe e ruejshin si djalin e tyre. Nuk kishte nanë aktiviste që të mos e njipte Malin, këtë djalë të popullit.

Ja se ç'na tregon një nanë dëshmori:

«Mali vinte shpesh në shtëpinë tonë. Ai gjithmonë ishte i qeshur e gojambël. Kurrë s'e kam pa të mërzitun. Hapte lehtë derën e oborrit dhe kur u afrohej shkallëve më thërriste: «Nanë!» Më shikonte me ata sy porsi dy xhixha, më hidhte krahun dhe, tue u drejtue nga kuzhina, thonte tue buzëqeshë:

— E, nanë, ç'na ke ba me hangër?

Unë e vështrojshe me vemendje dhe mandej u bijshe krahëve të tij të shëndoshë. Nxirrshë prej çarranikut ose petlla me djathë, ose tërhan të përpluëm me zhisla, ose i vejshe para pjatën me sazerm, të cilin e pëlqente aq shumë. Hante me shije dhe thonte:

— Të lumshin duert, moj nana jonë!

Më përqafonte dhe fluturonte atje ku e kishte punën. Ai ikte, dhe unë rrijshe tue mendue për të, njisoj si për djalin tim».

Shkodra e njofti shpejt djaloshin, që rrinte herë me këmishë të bardhë, herë me një triko leshi të kuqe me zinxhir deri në fyt, dhe me pantallona sport, atë djalë të thjeshtë, të dashtun, të shkathët

23827

e simpatik. Ai ditë e natë shkonte nga një bazë në tjetrën tue folë për çlirimin e vendit. Me punën e palodhun që bani Manushi, shumë të rinj u hüdhen në rreshtat partizane.

Manushi ishte pa prind, po prapseprapë ai e kapërxente këtë brengë, sepse jetonte në gjinin e popullit dhe ishte ba bir i dashun i tij. Për këtë Manushi një herë më thonte:

«Nana ime më pat lanë foshnjë në djep dhe unë nuk e mbaj mend as për fytyrë. Baba më kujtohet, por kur vdiq isha i vogël, në të parën fillore. Megjithatë, nuk e ndjej se jam jetim. Kudo që shkoj më duket vehtja si në shtëpinë time. Nanat e shokëve të mi, njato plakat e mira të Shkodrës, që na duen, na ndihmojnë dhe na mbajnë, më janë ba nana të vërteta, si të isha djali i tyne».

Lufta jonë Nacional-Çlirimtare qe një shkollë e vërtetë, që kaliti një brez të tanë revolucionarësh të dalun nga gjini i popullit. Manushi i përkiste këtij brezi të lavdishëm revolucionarësh, ai ishte i hedhun në punë, organizator i mirë dhe sidomos i premë për punën me rininë. Kish një kujtesë të mrekullueshme. Mjaftonte që ta shifte të riun e t'ja ndigjonte vetëm një herë emnin, dhe do ta mbante mend për gjithmonë. Ai dinte me u miqësue shpejt me njerëzit, që në takimin e parë dinte t'ua fitonte zemrat dhe sillej me ta sikur t'ishte njoftë prej shumë kohësh.

E mbaj mend si bisedonte. Ishte i zoti në të folun, i logjikshëm dhe i thellë në mendime.

Kur ja niste bisedës, fliste me za t'ulët, mandej, e ngrinte zanin simbas rastit, e, megjithëse i mbahej pak goja, kishte diksion të mirë, fliste rrjedhshëm dhe natyrshëm, dinte me nxjerrë kon-

kluzione logjike dhe me argumenta bindëse, dinte me i bashkue e me i mobilizue njerëzit për lëvizjen revolucionare.

Manushi nuk ka qenë vetëm një gojtar i mirë, por edhe një organizator i shquem. Përvoja e punës me rininë në Tiranë e ndihmoi mjaft në zgjidhjen e detyrave të ndërlikueme të luftës ilegale në Shkodër, sidomos në periudhat e reaksionit të madh, ku u kalit dhe ma shumë revolucionari i ri. Manushi ishte shumë i disiplinuem dhe i përpikët në punë.

Kam patun rastin me pa disa herë se si vepronte Manushi ndër bazat ilegale.

Zakonisht ai binte me fjetë natën vonë, sepse shkruente e lexonte me orë të tana. Mandej, mbasi bante ndonji shaka të vogël, shkonte në fund të minderit, hiqte vetëm këpucët e xhaketën.

Rrobet e tjera i mbante veshë, për të qenë gati për çdo rast. Letrat, bllokun e shënimeve dhe materialin tjetër konspirativ, bashkë me shkrepset e shishen e benzinës, i vendoste në një vend të caktuem e të sigurt; për më i zhdukë në rast rreziku. Revolen e fuste nën jistik dhe mandej flente. Por flente pak, sepse zgjohej shpejt dhe, sa zbardhte drita, fillonte aktivitetin me një vrull gjithnjë edhe ma të madh.

ETJA PËR DIJE

Manush Alimani kishte dëshirë të madhe për kulturë. Ai ka mbetë në kuitesën time feminare, si nienj nga të riitë e Shkodrës me një horizont të gjanë kulture për atë kohë. Ai dinte shumë giana, lexonte vazhdimisht libra politike dhe artistike.

Shpesh lexonte libra të ndryshme nga gjuha italishtë, të cilën e kish mësue në shkollë, sepse, sikurse dihet, në atë kohë në gjuhën amtare kishte pak libra të përkthieme. Një bashkënxanës i tij tregon se, që kur ishte nxanës në klasën e pestë të gjimnazit të Shkodrës, në vitin 1940-1941, Manushi lexonte disa nga veprat e Maksim Gorkit të përkthyer nga italishtja në gjuhën shqipe si «Nëna» etj, kurse nga italishtja kishte lexuar «Nelle carcere Russe», «Nella steppa», «I vagabondi» etj.

Në shijen artistike të dëshmorit — vazhdon të tregojë bashkënxanësi i tij — pat ndikue mësuesi i letërsisë, poeti i talentuem Gasper Pali.

Disa herë, gjatë periudhës së reaksionit të dimnit 1943-1944, pata rastin me qenë afër tij. Unë e njifsha si udhëheqës kryesor të rinisë, por në të njajtën kohë ai kishte pasë përgjegjësi të madhe edhe në Qarkorin e Partisë. N'atë kohë punohej në kushte shumë të vështira ilegale, e, megjithese nga çasti në çast mund të kapej ose të vritej, ai nuk e lente leximin e librave.

Më kujtohet një natë e ftofët frori të vitit 1944. Atë natë u ndodha në një bazë ilegale, ku shpesh strehoheshin Manushi dhe disa shokë të tjerë dhe ku baheshin edhe mbledhje të Qarkorit. Jashtë frynte murlani i tërbuem. Ishte shpallun shtet-rrethim dhe qoshe më qoshe përgjoreshin forcat e armatosuna anmike. N'atë lagje nuk kishte dritë elektrike, prandaj dhoma ndriçohej vetëm nga flaka e druve, që ndizeshin në votër dhe nga një kandil i vogël me gypin gjysëm të nximë prej tymit, që ishte varun mbi mur. Unë isha ulë bri votrës dhe kuvendojsha lehtë së bashku me të zotin e shëlpisë,

me të shoqen e tij, e cila ishte një patriote e vërtetë dhe me djalin e tyre, që e kisha shok të ngushtë, ndërsa Manushi, mbasi shkruajti diçka, filloi me lexue aty në minder. Kishte në dorë një fletore të trashë me kopertinë të zezë. Lexonte diçka dhe herë mbas here e ngrinte aq nalt zanin sa të gjithëve padashun na bante me shikue në drejtim të tij. Kështu lexoi për një kohë të gjatë nën dritën e atij kandili të vogël, mandej u ngrit më kambë, u afrue ke ne dhe, tue shtri duert mbi zjarrin e votrës, tha:

«Oh, sa bukur ka shkruie Migjeni! Nuk ngihem tue e lexue. Në këtë fletore kam disa pjesë të Migjenit të kopjueme me dorë nga shokët tonë.» dhe muer frymë thellë.

SI E NJOFTA SHOKUN MALI

Isha n'oborrin e gjimnazit, kur një shok më njoftoi për orën dhe vendin e mbledhjes.

— Kujdes — më tha. — Në mbledhjen tonë do të vijë edhe një shok me randësi i Komitetit Qarkor. Kjo më bani me mendue. Do të njifem me një shok ilegal, thashë me vehte, dhe prita me padurim kohën e takimit tonë. Meqë s'kisha pa ndonjiherë ndonjë shok ilegal, fillova me e përfytyrue në mënyra të ndryshme.

Në kohën e luftës, mbledhjet zhvilloneshin me kujdes dhe në mësheftësi të madhe, sepse spiunët gjyrmojshin kudo. Kjo mbledhje për ne kishte një randësi të veçantë, prandaj e pritshim me padurim.

Mbas pak, mbasi ishin mbledhun të gjithë anë-

tarët e aktivitet, në dhomë hyni përgjegjësi i aktivitet, i shoqëruem nga një shok tjetër dhe tue buzëqeshë u ulën në një minder.

Mue nuk më shkoi mendja se shoku që hyni në dhomë ishte i deleguemi i Qarkorit, prandaj po pritsha me padurim. M'ëpo menjherë përgjegjësi i aktivitet u ngrit në kambë, e muer fjalën dhe, simbas rendit të ditës, bani informacionin mbi gjendjen politike. Mbas tij e muerën fjalën edhe tre katër anëtarë të aktivitet. Mbas këtyne diskutimeve përgjegjësi i aktivitet ja dha fjalën të deleguemit të Qarkorit — Malit.

Manushi ishte një djali i ri në moshë, por i pjekun, i matun dhe të bante për vete. Kishte fytyrë të bukur, me sy të vegjël, por të zjarrtë e depërtues, flokë të qethun shkurt, trup mesatar dhe shpatulla të gjana. Ishte i pastër, i rregullt në paraqitje, mbante një këmishë të bardhë me jakën të nxjerrun mbi një xhakëtë bojë hini.

Para se me fillue me folë, lëvizi prej vendit tue dashtë me na u afrue ma tepër. Fliste kuartë, me za të ulët, mengadalë, sikur të belbëzontë, dhe na shikonte me sytë e tij të bukur.

Ai u përpoq me na spjegue gjendjen politike të asai kohe, të jashtme dhe të mbrendshme. Biseda e Manushit ishte aq interesante, sa të gjithë anëtarët e aktivitet u entuziazmuen dhe ngelën tepër të kënaqun.

Mandej, simbas rregullit të mbledhjeve të atëherëshme, raportuem secili për punën e bame me rininë shkollore dhe muerëm udhëzime të reja.

Përgjegjësi v në kohë mbas kohe bante pvetie e ndërhynte, simbas rastit, kurse shoku i Qarkorit ndiqonte me vemendje dhe na jepte kurajo dhe këshillë të vlefshme. Si mbaroi mbledhja, natën

vonë, një e nga një e dy e dy, vrapuem në shtëpitë tona, tue kujtue këshillat e shokut të Qarkorit, emnin e të cilit e mësuem disa dit ma vonë se mbledhja, dhe kjo ndodhi në muejin maj të vitit 1943.

SEKRETARI

Gjysma e dytë e vitit 1943 shënoi një ngritje të dukëshme të Lëvizjes Nacional-Çlirimtare për krahinën e Shkodrës. Batalioni partizan «Perlat Rexhepi», që u formue në këtë kohë, zhvilloj luftime të rrepta kundër forcave të shumta fashiste italiane, që lanë në fushën e betejës me qindra të vramë e të plagosun. Ma vonë, me urdhën të Shtabit të Përgjithshëm, batalioni «Perlat Rexhepi» zhvilloi një sërë luftimesh të guximshme kundër pushtuesve gjermanë dhe tradhëtarëve të vendit në krahinat e Tropojës, Kukësit, Plavës, Gucisë dhe Gjakovës, tue dhanë kështu një ndihmë të madhe për zgjanimin e Lëvizjes Nacional-Çlirimtare në Shqipërinë e Veriut.

Organizatat e partisë dhe të rinisë, si dhe këshillat nacional çlirimtare, kryejshin veprime të ndryshme, shtojshin radhët e luftëtarëve të lirisë dhe zhvillojshin një veprimtari të gjanë propagandistike në qytet dhe në malësi. Nga një raport, që i dërgohej në atë kohë Komitetit Qendror del se gjatë shtatorit të vitit 1943 kishte raste që në Shkodër dilshin edhe dy trakte në ditë.

Nën drejtimin e të deleguemit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Shqiptare, Vasil Shantos, komunistët dhe rinia kryen një numër të

madh aksionesh. E ashpër ra pushka e njisitit gueril të qytetit të Shkodrës mbi kokën e 30 veglave të pushtuesit, tue fillue nga spiunët e flliqun e deri tek qarkomandanti, major Ndrec Prenga, që u vra mu në pjacë të Shkodrës, aty përpara Kafes së Madhe.

Në një komunikatë, që qarkulloi në ato dit, thuhet tekstualisht:

«Dorë e drejtësisë së popullit, ekzekutoi mbrenda muejve gusht e shtatuer, spiunët e flliqun të Sim-it e të Kuesturës, Muhamet Xhyherin, Caf Danin e Çun Hajdarin. Ky i fundit kishte mbërri kulmin e krimeve të tija me spijunllëkun që bani vjetin e kaluem kundër dëshmorve të mëdhaj të popullit: Perlat Rexhepi, Branko Kadija e Jordan Misja. Batalioni partizan i Shkodrës ekzekutoi marshalin e kuesturës Simon Oroshin, veglën ma qorre të okupatorit, që kish torturue e marrë në qafë patriotët Shqiptarë në Kuesturën e Shkodrës dhe veçanërisht në atë të Tiranës. Më 20 shtator, u dogj kuestura e Shkodrës, foleja e plehnave dhe e poshtërsive bashkë me materialet dhe dokumentat. »¹⁾

Në këtë kohë, Manushi u caktue sekretar politik i Komitetit Qarkor të Rinisë Komuniste dhe anëtar i Komitetit Qarkor të Partisë për Shkodrën. Tash Rinia e njohu edhe ma shumë, edhe ma mirë, udhëheqësin e vet. Nuk kishte mbledhje, nuk kish-te takim rinie ku të mos merrte pjesë Manushi.

1) A.M.P. i Shkodrës.

Puna me rininë në atë kohë nuk ishte e lehtë, përkundrazi paraqiste vështirësi e pengesa të mëdha. Pushtuesit e rij, nazistët gjermanë dhe veglat e tyre, Balli Kombëtar, Legaliteti dhe sidomos kleri reaksionar, përdorën çdo gjë për të mbajtur nën ndikimin e tyre rininë e Shkodrës. Ata kishin organizue prej kohësh shoqni fetare, në të cilat grumbulloheshin rininë me anë aktivitetesh të ndryshme artistike dhe politike. Kleri dhe reaksionarët e tjerë, që i shërbejshin pushtuesit, villshin vner e helm kundër qëllimeve të shejta të luftës sonë, tue e paraqitë atë si «antishqiptare» e «prosllave», si lëvizje që shkatërron «fenë dhe atdheun». Por, pjesa ma e mirë, pjesa ma e zgjedhun, shumica dërmuese e rinisë së Shkodrës me përjashtime të vogla, ndigjoi fjalën e Partisë, braktisi klerin, urrejti pushtuesin, shkoi mbas Manushit me shokë dhe kreu me nder detyrën e vet ndaj popullit dhe Atdheut.

Gjendja e punës me rininë e Shkodrës, pasqyrohet kjartë, në raportin e hollësishëm që i dërgonte qarkori i rinisë Komitetit Qëndror me 1 nëndor 1943: ku ndër të tjera shkruhet:

«Situata e re, e krijueme nga jashtë, dhe gjendja e vështirë në të cilën gjindet fashizmi, situata e re, e krijueme nga mbrenda, me shtimin e forcimin e Luftës Nacional-Çlirimtare, ka ba që rinia e këtushme të ketë një shesh të gjanë pune.

Influenca e rinisë sonë mbi rininë antifashiste asht e madhe. Ndër të gjitha lagjet bahen konferenca të shpeshta të rinisë antifashiste e komuniste bashkë. Rinia asht vu

në korrent të situatës që kalojmë, d.m.th. para kryengritjes së përgjithëshme për vendosjen e Pushtetit Popullor. Rinia e tanë e ndjen vehtën anti-fashiste dhe mbas demaskimit sistematik dhe me zgjuetësi të reaksionit ndërkombëtar dhe të mbrendshëm, i urren reaksionarët deri në kulm; asht popullarizue mirë Shqipnia Demokratike Popullore.

Si në rininë anti-fashiste, ashtu edhe në popull, Balli Kombëtar dhe reaksionarët e tjerë, si zogistët, janë demaskue mjaft mirë. Balli, me politikën kundër Lëvizjes Nacional-Çlirimtare, kundra Partisë Komuniste, pro-okupatorit, me parullat e tij e ka humbë kredinë para rinisë, e cila asht prej natyre përparimdashëse dhe demokrate. Ndërkaq, influenca e Partisë dhe e Këshillit të Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar asht mjaft e madhe në rini.

Kleri po mban një qëndrim që të mund të dallohet në këtë luftë. Kleri ka akoma një pjesë të rinisë nën influencën e tij. Megjithatë, rinia po largohet nga shoqnitë që ka kisha.

Përveç një rinie të pavendosun dhe ma tepër pasanike dhe reaksionare, Balli dhe Kleri s'kanë gja tjetër në Shkodër» 1)

Kështu thonte raporti, që ishte përpilue e nënshkrue nga MALI, sekretari politik i Komitetit

1) A.M.P. i Shkodrës.

1943 26.10.43
 U. nate
 1. Si shprehim j me at...
 2. Gjatë...
 3. Dëshiroj...
 4. Në...
 5. Në...
 6. Në...
 7. Në...
 8. Në...
 9. Në...
 10. Në...
 11. Në...
 12. Në...
 13. Në...
 14. Në...
 15. Në...
 16. Në...
 17. Në...
 18. Në...
 19. Në...
 20. Në...
 21. Në...
 22. Në...
 23. Në...
 24. Në...
 25. Në...
 26. Në...
 27. Në...
 28. Në...
 29. Në...
 30. Në...
 31. Në...
 32. Në...
 33. Në...
 34. Në...
 35. Në...
 36. Në...
 37. Në...
 38. Në...
 39. Në...
 40. Në...
 41. Në...
 42. Në...
 43. Në...
 44. Në...
 45. Në...
 46. Në...
 47. Në...
 48. Në...
 49. Në...
 50. Në...
 51. Në...
 52. Në...
 53. Në...
 54. Në...
 55. Në...
 56. Në...
 57. Në...
 58. Në...
 59. Në...
 60. Në...
 61. Në...
 62. Në...
 63. Në...
 64. Në...
 65. Në...
 66. Në...
 67. Në...
 68. Në...
 69. Në...
 70. Në...
 71. Në...
 72. Në...
 73. Në...
 74. Në...
 75. Në...
 76. Në...
 77. Në...
 78. Në...
 79. Në...
 80. Në...
 81. Në...
 82. Në...
 83. Në...
 84. Në...
 85. Në...
 86. Në...
 87. Në...
 88. Në...
 89. Në...
 90. Në...
 91. Në...
 92. Në...
 93. Në...
 94. Në...
 95. Në...
 96. Në...
 97. Në...
 98. Në...
 99. Në...
 100. Në...

Faksimile nga shënimet e Manush Alimanit mbajtur në mbledhjen e Komitetit Qarkor të Partisë Shkodër (dhjetor 1943)

27

Qarkor të rinisë për Shkodrën. Dhe me të vërtetë edhe rinia e Shkodrës, si gjithë rinia shqiptare, ishte radhitë në luftën revolucionare, për shpërrjen e pushtesit, për vendosjen e Pushtetit Popullor, për Shqipërinë Demokratike Popullore. Pikërisht në atë kohë në Shkodër kishte 595 të rinj komunistë, prej tyre 450 punëtorë dhe nxanës, 95 në fshat, 50 në batalionin partizan «Perlat Rexhepi», përveç qindra të tjerëve, anëtarë të Bashkimit të Rinisë antifashiste.

Gjatë periudhës shtatuer deri në gjysë të nandorit të vitit 1943, kur «Mysafirët e paftuem» gjermanë pushtuen vendin tonë, lëvizja në Shkodër u zgjanue edhe ma shumë. Njisiti gueril ishte në gadishmëni luftarake dhe gadi për çdo ditë zhdukte spiunë e tradhëtarë mu në hundë të gjermanëve.

Por, tue fillue nga gjysma e dytë e nandorit po të këtij viti, forcat reaksionare në Shkodër, të kryesueme nga Balli Kombëtar, Legaliteti dhe organizatat e tjera tradhëtare, të përkrahuna drejtëpërsëdrejti nga pushtesit, filluen me e shtue veprimtarinë e tyre tradhëtare anti-shqiptare kundër lëvizjes nacional-çlirimtare. Nga fillimi i dhetorit të vitit 1943, gjermanët e tradhëtarët suellën në Shkodër regjimentin «Kosova», mblodhën dhe i vërsulën kundër lëvizjes së popullit njerëzit ma të degjeneruem si katilat e Myslim Bejgorës e të Hasan Isufit, xhandarët e Llesh Marashit e të Shaban Elezit, cubat e Gjon Markagjonit e të Prengë Calit, spiunat e Hauzdingut e të Mato Muratit, njerëzit e Ballit e të legalitetit, klerikët reaksionarë, të cilët me veprimtarinë e propagandën e tyre helmuese dhe anti-kombëtarë kërkonin me e shue çdo frymë përparimtare që luftonte për liri e pavarësi. Ata shpallën shtet-irrethimin, organizuen arrestimet në

masë, zbatuen torturat ma bërë, vrasjet nëpër rrugë për dyshimin ma të vogël, internimet në kampet e çfarosjes, etj.

Në atë kohë, në Shkodër, kishte 12 vende ku mbaheshin njerëzit e arrestuem, të cilët ma vonë dërgoheshin në burgun e madh ose në kampet e përgëndrimit. Anmiku ndiqte e gjyrmonte kamba kambës çdo lëvizje të rinisë, shpesh herë ndalojshin të rijtë që qarkullojshin me biçikleta. Kishte raste që për dyshimet ma të vogla ndaloheshin të rijtë kur shifeshin tue ecë nga dy-tre së bashku. Organizuen kontrollin e përgjithshëm të letër-njoftimeve, tue vu shënime me bojë të kuqe në dokumentat e të rijve sado pak të dyshimtë.

Reaksioni u përhap edhe në fshat. Tue u mbështetë në bajraktarët, vojvodët, klerikët reaksionarë e tradhëtarët e ndryshëm, dhe tue shfrytëzue mbrapambetjen e padijen që ekzistonte në krahinat e Veriut, pushtuesi dhe veglat e tij organizuen besëlidhje të ndryshme dhe mundën me mbajtë nën ndikimin e tyne disa zona të malësive tona.

Nëpër rrugët e Shkodrës u vranë shokët tanë ma të mirë. Me 10 janar 1944 nga plumbat e regjimentit «Kosova», gjetën vdekjen antari i Komitetit Qarkor të Partisë: Sherif Hoxha dhe revolucionari Hajrulla Kastrati. Nuk kaluen veç 12 dit, i rrethuem në një shtëpi të vogël të Perashit të Kuq, në luftë e sipër, u vra anëtari tjetër i Komitetit Qarkor të Partisë, trimi Danjel Matlija. Mbas 10 ditësh, me 1 Shkurt 1944, u vranë tue luftue në breg të liqenit të Shkodrës, kandidati i Komitetit Qëndror të Partisë, Heroi i Popullit Vasil Shanto dhe komunisti Reshit Rusi.

Anmiku kishte për qëllim me shpartallue krejt

Lëvizjen Nacional-Çlirimtare në krahinën tonë, me armatosë gjithë veriun, për ta përdorë atë si mish për top, kundër Lëvizjes Nacional-Çlirimtare në krahinat e tjera të Shqipnisë, me e përdorë Shkodrën si urë kalimi për ushtritë e shpartallueme gjermane n'ikje, me e pasë veriun gati në rast të ndonji zbarkimi.

Në këto kushte të vështira u shque edhe ma tepër figurë revolucionare e Manush Alimanit. Af-tësitë dhe talenti i tij u zhvilluen në mënyrë të çu-ditshme në ato rrethana të vështira të rezistencës. Që kur filloi operacioni i madh i dimnit, Manushi kaloi drejtpërsëdrejti në udhëheqje të organizatës së partisë, tue krye funksionin e sekretarit organi-zativ të Komitetit Qarkor të Partisë, dhe në vënd të tij në udhëheqjen e rinisë u caktue një shok tje-tër i Qarkorit të Partisë.

NJI MOTOR I VOGËL, QË S'PUSHONTE AS DITE AS NATË

Periudha ma intensive e jetës së Manush Alima-nit, ishte periudha e reaksionit. Na, që e patëm răs-tin me punue me të n'atë kohë, nuk mund ta ha-rrrojmë kurrë.

Nji ditë, kur çoi me më thirrë te fusha e Tigrin në Xhabijej (vend takimesh i shokëve ilegalë me të rijtë e simpatizantët e luftës), e pashë Manushin shumë të mërzitun. Ishte 1 shkurt i vitit 1944, ora 8 e mëngjesit. Bante ftofët. Manushi kishte veshë nji pallto të madhe bojë bezhë, dhe kishte vu nji kasketë me kuadrate bojë kafe. Tash Manushi pu-

nonte në ilegalitet dhe n'ato dit e kërkojshin rrugë më rrugë e lagje më lagje.

Dukej shumë i pikëlluem. Ai më porositi që të shkojshe para prefekturës, ku ishin ekspozue tre shokë të Partisë të vramë nga anmiku. Të vrejshe me kujdes fytyrat e veshjet e tyne dhe menjherë t'u kthejshe me i njoftue. Dhe kështu veprova. Shkova atje, u futa në grumbull të njerzve dhe me kokë të ulun vrejta me vemendje shokët e vramë.

U ktheva përsëri në atë vend ku më priste Manushi. Fillova me i tregue: «... ishte i gjatë, i veshun me rrobe malësorësh, me ballë të gjanë, me flokë të ramë, me mustakë të trashë, me dhambë të vumë...» Nuk më la me mbarue fjalën.

— Mjaft! E kuptova. E dijshe, por s'më besohej. Ai asht. . Veliu. — Ishte vra trimi i trimave, Vasil Shanto.

Mandej Manushi uli kokën, diçka mendonte, shpejt e shpejt shkruajt një letër të vogël, të cilën ja çova një shokut të qarkorit, që ishte ilegal në lagjen Ndocaj.

Gjatë atyne ditëve të paharrueshme e shifshë Manushin në të katër anët e qytetit, në çdo lagje e në çdo rrugicë. Sa zbardhte drita, ai fillonte lëvizjen nga Perashi e në Arrë të Madhe, te Baja e Vogël, ose nga Sardarej në Tophanë, në Lugëçezme, nga Ndocaj në Dudas, në Dërgut ose në Kiras, etj. Tash këtu, ma vonë atje. Sa rrethohej një shtëpi ai kalonte në bazën tjetër, sa zbulohet një bazë, ai shkonte në një bazë tjetër.

Ai gjindej kudo. Në mëngjes takohej me disa të rij antifashistë, mbas dite me një grup punëtorësh, etj. Herë tue aktivizue ndonji pionier të guximshëm, herë tue u folë grave aktiviste dhe nanave patriote, kurse natën bisedonte me pleqtë simpa-

tizantë të lagjeve të vorfna. Sot në teknikën «Mjerimi», ma vonë te «Prushi», ku shtypeshin trakte të partisë. Ai ishte ba me të vërtetë si një motor i vogël, që s'pushonte as ditë as natë.

2 MAJ 1944

Nji ditë të bukur maji, në nji rrugë të heshtur të lagjes Shabanej, mu në krye të kthesës që të çon në breg të liqenit, mbas murit të vorrezave të xhamisë, ishin mshefë xhandarët e Llesh Marashit. Atë ditë Manushi duel nga shtëpia e nanës Gufe, ku strehohej prej disa ditësh, dhe bashkë me nji shok tjetër u nis për t'u takue me nji korier të partisë, që kishte ardhë nga Tirana. Por pa mbërri ke vendi i caktuem, u arrestue në befasi nga anmiku. Xhandarët kuinslingë, me në krye tetar Sadikun e Vogël, iu huldën Manushit në fyt, e kapën, e lidhën me pranga hekuri dhe, bashkë me nji shokun e tij, i dërguen në prefekturë. Ishte 2 maji i vitit 1944.

Për organizatën e partisë e të rinisë komuniste, për Lëvizjen Nacional-Çlirimtare të qarkut të Shkodrës, arrestimi i Manush Alimanit qe nji humbje e randë. Anmiqtë mendojshin se me arrestimin e Manushit nuk do të zhdukshin vetëm një komunist të rrezikshëm, por ishin të bindun se nëpërmjet tij do të zbulojshin edhe gjithë organizatat e partisë dhe gjithë bazat partizane në Shkodër. Por ata nuk ja mbërrinë këtij qëllimi.

Për arrestimin e Manushit na flet me hollësi Ymeri, shoku që u arrestue bashkë me të.

«Më 30 prill — thotë Ymeri — një korier i posaçëm pruni nga Tirana dy zarfa konspi-

native. Ai mbasi më dorëzoi letrat, kërkoi që të takohej me shokun Mali për një punë me randësi. Mali, në atë kohë nuk lëvizte shumë, për arsye të reaksionit të madh, sepse gjyrmohet shumë nga pushtuesit e tradhëtarët. Mbasi biseduem pak për datën dhe vendin e takimit u nisa menjherë për në shqipëri e nanës Gufe në lagjen Dudas, ku qëndronte Mali si ilegal dhe i dorëzova të dy zarfet e mbylluna dhe ma në fund i thashë edhe për takimin që kërkonte korrieri. Mali u mendue pak dhe vendosi që takimi të bëhej me 2 maj. Më 2 maj shkova në bazë për me u takue me Malin. Nanë Gufja na poqi dy kafe të mira dhe me zor e lejoj Malin me dalë prej shtëpisë së saj. Ai e përqafoj nanën Gufje, tue e sigurue se s'do të vonohej e do kthente përsëri. Më futi krahun dhe na dualëm në rrugë. Filluem me ecë me kujdes drejt «vendit të shpëtimit».

«Dhetë dit më parë, tue kalue me Malin nëpër lagjen Ndocaj, për me takue Petritin¹⁾, rastësisht na duelën përpara një grup xhandarësh me në krye kapiten Shaban Elezin. Ata na vrejtën dhe, mbasi dyshuen, filluen me na ndjekë. Na u futëm në një rrugicë të gjatë, kapërcyem një gardh dhe, tue kalue nga kopshti në kopsht, duelëm te Xhamia e Shaban Efendisë. Xhandarët u frynë bilbilave, kërcitën shulat e pushkëve, dhe vrapuen mbas nesh. Por nuk mundën me na kapë. Na muerëm drejtim kah Buna, kaluem

1) Petriti — Pseudonim i shokut Sait Bushati gjatë Luftës N.Çl.

fushat me ujë dhe mbërrimë afër Pazarit të Vjetër. Prej aty shkuem në Luguçasme, ku u strehuem në bazën tonë.

— Mali, me këtë rast, i quejti livadhet në krahun e majtë të xhamisë së vjetër në drejtim të Liqenit, «vendi i shpëtimit». Dhe na të dy, atë ditë maji ishim tue shkue për takim në «vendin e shpëtimit».

Kur mbrijtëm afër xhamisë së vjetër, buzë rrugës së ngushtë që të çon ndër livadhe, ndërsa Mali po më thonte se reaksioni asht i përkohshëm dhe se na, patjetër, do të fitojmë, papritë e pakujtue disa xhandarë me në krye Sadikun e Vogël, që e njipte Malin, na rrethuen dhe na i vunë pushkët në gjoks e në kokë. Ishte e pamundun me lëvizë, sepse ata na kapën dhe na i shtrënguen duert me pranga. U shikuem sy në sy. Mali shtrëngoi dhambët.

Kaluem prej vendit të arrestimit, me duer të lidhuna dhe të rrethuem prej xhandarëve, nëpër lagjen Tophanë, kah rruga Koplikej, që ishte rruga kryesore, nëpër Parrucë dhe na çuen në Prefekturë, ku na ndryen të dyve në një dhomë të vogël të katit të parë afër burgut të madh. S'vonoi shumë, dhe, krye minutit, ke sporteli i vogël i derës me hekura, nxirrshin kokën për të na shikue agjenta të ndryshëm civilë e ushtarakë, të cilët me ankth e me kureshtje pyetshin: «Cili asht Mali?» Por sa na futën në atë dhomë t'errët, Manushi filloi me veprue. Zhduku letrat që kish pasë me vehte dhe u kap mbas hekurave të dritares që binte kah burgu i madh. Aty afër bante roje me push-

kë në krah një xhandar prej malësive të Shkodrës. Manushi filloi me i folë afërsisht kështu: «Kujt i shërben, o xhandar? Kush ta ka dhanë dhe për cilin do të luftosh me atë pushkë të gjatë? Ty të kanë gënjye e të kanë marrë në qafë. Të kanë thanë se jemi «shkje», por ne jemi komunistë, shqiptarë të vërtetë, që i kemi dalë zot vendit, që s'na dhimbet jeta për Shqipninë. Xhandar, o xhandar, bashkohu me ne, e atë pushkë të gjatë ktheja pushtuesit e tradhëtarëve të vendit».

Biseda me xhandarin vazhdoi sa ndejm në burgun e Prefekturës, prej ku Manushi mundi me sigurie lidhje me shokët e qytetit — vazhdon Ymeri. — Natën e parë na muerën në pyetje Llesh Marashi e Shaban Elezi, i pari qark-komandant dhe i dyti komandant i xhandarmërisë së qytetit. Ishte ora 9 e mbramjes kur duelëm përpara këtyne dy katilave. Në fillim tradhëtarët e flliqun u përpoqën me u tregue të «njerzishëm» dhe kërkuen prej Manushit disa njoftime të zakonshme për vendlindjen e profesionin. Manushi u përgjegj shkurt. Ma vonë ata i thanë se ai ishte Mali, por Manushi e mohoi këtë në mënyrë të preme. Atëhere qark-komandanti kërkoi që Manushi të shkruente me dorën e vet përgjigjet e disa pyetjeve që do t'i bajshin. Ai diçka u kujtue dhe mendoi, mori pendën dhe shkroi një 4-5 rreshta mbi letrën e bardhë; ai shkruetj se ishte student. Banonte në Tiranë. Kishte ardhë në Shkodër te daja, etj., etj. Qark-komandanti ja muer letrën prej duerve dhe hapi menjherë syrtarin e tryezës së tij prej

ku nxuer disa letra të shkrueme me dorë. Shikoi të dy shkrimet, bani krahasimin midis tyre dhe, tue iu drejtue kapitenit, tha:

«Dora vetë. Shkrimi njisoj. Puna u skjarue. Kemi në dorë një nga shefat e komunistëve të Shkodrës» — dhe u krenue tepër i gëzuem. Çeshtja qëndronte te një dorëshkrim i Manushit, që i kishte ra në dorë anmikut, por Mali dhe shokët e tjerë të Qarkorit nuk e dijsin. Kur atij iu kërkue me shkruë përgjigjet me dorë, ai diçka u kujtue. Mendoj se mos kishte ra në dorë të anmikut ndonji letër e tij me shokët e organizatës së Shkodrës. Prandaj, mbasi mendoj pak, vendosi me shkruë jo me shkrimin e tij të zakonshëm, por me një shkrim tjetër, që përdorte kur i shkruente Qendrorit të Rinisë në Tiranë.

Por dokumenti që kishte në dorë qark-komandanti ishte një raport që i drejtohej Komitetit Qëndror të Rinisë. Raporti ishte shkruë me dorën e Manushit dhe në fund nënshkruhej në emër të komitetit qarkor të rinisë për Shkodrën nga sekretari politik — MALI.

Tue ba krahasimin e shkrimeve, qark-komandanti kërkonte që Manushi të tregonte, se cilët ishin shokët e Qarkorit, që në raport përmendeshin me pseudonimet: Petriti, Kujtimi, Flamuri, Tigri etj. Ai donte me përpilue shpejt listën emnore të antarëve të partisë, të rinisë komuniste, të bazave ilegale në qytet e në fshat, të vendeve ku shtypeshin traktet e partisë. Ai kërkonte me zbu-



Tre anëtarët të Komitetit Qarkor të Rinisë Komuniste të Shkodrës në vitin 1943 (Ahmet Haxhia, Manush Alimani dhe Sait Bushati.

lue lidhjet me Qendrorin në Tiranë. Ai donte me zbulue prej Manushit krejt Lëvizjen Nacional-Çlirimtare të Qarkut të Shkodrës. Dhe ishte i bindun se Mali i dinte të gjitha.

Por Manushi i ri qëndronte i patundun përpara qark-komandantit të tërbuem dhe mohonte çdo gja, tue dhanë një përgjigje:

«Unë as nuk jam dhe as nuk e njof komunistin MALI» — Ata u lodhën tue e rrafë Manushin me shputa, me shqelma e me grushta, dhe nuk nxuerën prej tij asgja. Torturat vazhduen pesë dit me radhë, por Mali ishte ba një shkamb i vërtetë dhe hidhte poshtë me vendosuni çdo akuzë. Deri në vdekje nuk do të më shlyhet nga kujtesa fytyra e bukur dhe fisnike e Manush Alima-

nit. Qysh nga çasti që na vunë prangat e deri sa Malin e muerën e s'e kthyen ma në atë dhomë të vogël, e që nuk e pashë ma, ai mbante një qëndrim të papërkulun e burrnor. Ai nuk trembej fare nga torturat e vazhdueshme, ai luftoi edhe në qeli për demaskimin e anmiqve dhe për fitoren e luftës çlirimtare. Këtë e shifshë sa herë që e kthejshin në birucë të nximë e të përgjakun nga të rrafunit. Ai m'u dukte gjithnji e ma aktiv, ma i vendosun, ma trim e guximtar, ma i madh se sa e kisha njoftë ma parë.

Më duket se më 7 maj 1944, andej kah ora 10 para dreke, dera jonë shungulloi nga të trokitunit. Çelsat e randë banë zhurmë të madhe. Diçka e tmershme kishte ndodhë. Në dhomën tonë nuk hynë ma xhandarët me mustakë të gjatë. Në vend të tyne erdhën SS-ët gjermanë, të cilët, mbasi e lidhën me hekura, e muerën Malin me vehte. Ai eci me kambë rrëshanë, më shikoi ndër sy, luejti buzët dhe ngriti kokën përperjetë. Deshti diçka me më thanë, me më dhanë zemër, por gjermanët s'e lanë me folë dhe, tue i ra me çizmet e randa, e nxuerën përjashta dhe u futën në një makinë të zezë. Manushin e dashtun nuk e pashë ma, veç për një kohë të gjatë më tingëlluen fjalët që më pat thanë një natë ma parë:

«Të gjitha torturat që më bajnë këta të poshtër nuk më tundin, sepse jetën ja kam falë Partisë».

I VENDOSUN GJER NË VDEKJE. . .

Tue mos mujtë me nxjerrë asnji fjalë prej tij, tue mos mbërritë me kuptue asnji emën prej raportit të tij, krimineli Llesh Marashi ja dorzoi Manushin Hauzdingut, majorit gjerman.

Aty, në qelinë e Gestapos, u zhvillue një luftë për jetë a për vdekje midis revolucionarit të ri të lidhun, por të papërkulun, dhe shefit kapadai të Gestapos e të veglave të tij. Hausdingu i sprovuem në sa e sa krime të krveme nëpër Europë, kësaj radhe kishte punë me një djalë të ri, që s'i kishte mbushë ende të njëzetat.

Shefi nazist, ishte i bindun se me mënyrat e tij mund të bante me folë edhe një të vdekun, e jo ma një djalosh si Manushi ynë.

Edhe në Gestapo nvetiet vërtiteshin rreth raportit që i drejtohej Komitetit Qendror të Rinisë. Qëllimi kryesor i Hausdingut ishte me ba që i arrestuemi të pranonte se asht njeriu që mshifej nën pseudonimin Mali dhe mandej raporti do të sqarohet plotësisht.

Pvetiet filluen, me gjithë farë premtimesh, për një jetë të mahnitëshme, si në përrallat arabe. Mjaf-tonte oë i arrestuemi të tregonte, dhe Hausdingu do t'i siguronte një jetë princi, larg Shqipnisë, diku larg, pa e njof'të kush, në Kajro ose Teheran, në Berlin ose në Tokio. Por Manushi, me krenarinë komuniste shqiptare, i hudhi poshtë me neveri premtimet e laikat e shumëllojshme të Gestapos gjermane. Ai kishte vendosë me vdekë në Shqipni e mos me i tradhëtue shokët e vet. Për të, çmimi ma i naltë ishte që të rronte Partia dhe të fitonte populli, tue ja ba hallall jetën e vet të re.

Mbasi premtimet nuk dhanë ndonji rezultat, filluen torturat. Në fushën e torturave majori Hausding dhe kapiteni Otto e mbajshin vehten specialistë të përkryem dhe besojshin se shpejt do ta bajshin me u dorzue këtë çunak të ri. Ata snpresojshin se me shputa e grushta do të mund ta përlulshin komunistin e lidhun me hekura, dhe do të zbulojshin prej tij shumë sekrete.

Por u gabuen. As Hausdingu dinak e i tmer-shëm, as kapiteni Otto, me trup të madh, as gjermanët e tjerë nuk mundën me i nxjerrë Manusnit asnji fjalë, nuk mundën të provojsnin asnji akuzë.

Në burgjet e errta të Gestapos gjermane zvi-llohej faza ma tragjike, por edhe ma heroike e jetës së Manush Alimanit. Aty u vunë në provë dhe ndriçuen si kristali ato veti karakteristike që pati Manushi që në moshën ma të re dhe që u zhvilluen ma tej gjatë luftës revolucionare në Tiranë e në Shkodër, si ndershmënia, altruizmi, besnikia ndaj shokut, guximi, vendosunia dhe besimi ndaj idealeve të Partisë.

Tue qenë ballë për ballë me anmikun e tër-buem, Manushi, i edukuem nga Partia me ideale të nalta, ja kushtoi edhe jetën e tij të re kauzës së Partisë dhe të popullit. Ky ishte qëllimi i tij i shejtë. Këtu ne shohim forcën e madhe morale të këtij revolucionari të pamposhtun.

Gjatë kohës që qëndroi në duert e SS-ve gjermanë, Manushi u torturue kryesisht në burgun e madh të Komandaturës gjermane, që ishte vendosë në një shtëpi të vjetër shkodrane dhe nën shkalët e shtëpisë së sotme të kulturës, ku atëhere ishte vendi i torturimit të patriotëve nga SS-ët.

Viktoria, një shoqe e luftës, tregon:

«Në maj të vitit 1944 kam qenë e arrestueme në burgun e madh të gjermanëve në një shtëpi të vjetër tek ish shkolla fillore «Skanderbeg». Manushin e kishte në dorë kapiteni gjerman Otto, një oficer me trup të madh. Ai e torturonte në një dhomë të veçantë të katit të parë, për çdo ditë e për çdo orë, me gjithfarë metodash: me shputa, me grushta, me shufra hekri...

Mbasi lodheshin tue e torturue, e lidhin me zinxhirë, e futshin në maqinë dhe e çojshin në zyrat e Gestapos, ku e merrte në pyetje vetë Hauzdingu — shefi i SS-ve për Shkodrën. Më kujtohet si sot takimi i fundit me Manushin. Më kishin nxjerrë n'oborr, kurse ai qëndronte mbas dritares së dhomës në qoshe të burgut. Më bani za. U afrova dhe u çudita me pamjen e tij. Ishtë dobësue dhe i kishin dalë mollëzat e faqeve. Sytë e tij m'u dukën si ma të mëdhaj dhe gropëzat e syve, të nxime nga torturat. Këmishën e kishte të shkyeme dhe vende-vende me njolla të kuqe giaku. Megjithatë, me buzëqeshje filloi me bisedue me mue:

— Mos u mërzit, — më tha, — kam marrë vesh se edhe pak do të na mbajnë në këtë xhehnm. sepse këto dit do të na internojnë jashtë Shqipnisë. Kudo që të na çojnë, ne do të arratisemi për ta vazhdue luftën tonë për çlirimin e vendit. Mos kja për mue. Ma merr mendja se kaloi faza ma e vështirë. Çfarë nuk kanë ba mbi mue, sikur po e shef, por nuk kanë nxjerrë. as nuk do të nxjerrin asnjë fjalë prej meje. Tash nuk kanë çka me më ba. Le të rrojë Partia!

Mos u mërzit, Viktore, qëndro ashtu si i ka hie Rinisë Komuniste Shqiptare, na patjetër do të fitojmë, — përfundoi Manushi, tue shtërngue hekrat me duert e nxime dhe i dha gjoksit përpara që dukej nën atë këmishë të shkyeme dhe të skuqun me gjakun e tij».

Kur kujtoj fjalët e Vitores, unë përpiqem me e përfytyrue Manushin në ato çaste të randa. Porsi në vegim më del fytyra e Manushit, por jo ma me atë këmishën e pastër, të bardhë, me jakën e nxjerrun sipër xhaketës, ashtu si e kisha pa kur erdhi në Shkodër dhe gjatë ditëve të reaksionit. Edhe unë kam fillue ta përfytyroj Manushin, atë djalosh të guximshëm, si ndonji figurë legjendare, që tregohet në vargjet e poemës epike «PRISHTINA».


Manushi

këmishën e lame në gjak
po valon
Si flamur ngadhnjyes betejash.

Viktorja më ka tregue se Manushi për asnji çast nuk e humbi besimin në fitoren e popullit. Këtë e provon ma së miri letra e fundit që muerën shokët e qarkorit prej tij, të cilën ua dërgonte Manushi nga qelia e Gestapos.

29 MAJ 1944

Torturat vazhdojshin, por pa ndonji përfundim. Komanda eprorë gjermane kërkonte prej Hauzdin-



Manush Alimani dhetë ditë para arrestimit.

gut me çdo kusht që nëpërmjet deponimeve të Malit të zbulonte dhe pastaj të godiste organizatat e Partisë. Prandaj, Hauzdingu ishte ba ma i tërbuem dhe të gjitha torturat dhe pyetjet i drejtonte ai vetë.

Tri dit para vdekjes, Manushi ka shkruar edhe një letër tjetër, të fundit, të cilën u përpoq me e nxjerrë nga birucat e burgut. Këtë letër ai e pat shkruar me shifrën që shokët e Komitetit Qarkor të Shkodrës ishin detyruar me e përdorë në korespondencat e tyre në kohën kur reaksioni kishte mbërritur kulmin. Por, për fat të keq, letra u kap.

Hauzdingu dhe kapiteni Otto s'lanë torturë pa përdorë kundër Manushit. E shpuen me gjylypana e me gozhda, i futën spica ndër thonj e i vunë vezë të zime nën sqetull, ja lidhën trupin kushedi sa herë me tela dhe i lëshuen korrentin elektrik. E dërmuen për vdekje.

Manushi i dinte të gjitha. Nuk kishte bazë ilegale që të mos dinte, nuk kishte komunist që të mos e njifte. Po ashtu ai njifte të rijtë komunistë, të rijtë antifashistë, bile edhe çdo aktivist të qytetit të Shkodrës, por nuk tregoi asgjë.

Hauzdingu dhe kapiteni Otto u tërbuen edhe ma tepër nga qëndrimi i papërkulun i Manushit dhe me gjithë urdhnin e premë të Komandës eprorë, — **që ai njeri nuk duhej të vdiste** — ja ngulën bajonetën thellë në zemër dhe gjaku i tij i pastër ja skuqti këmishën e bardhë.

Hauzdingu përpoqi çizmet e randa për tokë dhe i ra ballit me forcë, tue uluritë: «Ky njeri nuk duhet të vdesë! Të thirret shpejt doktori, të ngjallet edhe njiherë, të flasë, patjetër duhet të flasë ky njeri».

Veglat e Hauzdingut e futën Manushin gjysëm të vdekun në një maqinë të zezë dhe e dërguen në spital.

Në kohën që doktori po i prekte pulsën, Manushi ynë i shtrenjtë dha shpirt. Ai vdiq, për t'u ba i pavdekshëm.

Kjo ndodhi më 29 maj 1944.

ATË DITË. . .

Nuk do ta harroj kurrë atë ditë. Së largu, nga fundi i rrugës së spitalit, po vijshin katër burra, që mbajshin në krah diçka. Kur u afruen vuna re se ishin katër hamaj, që bajshin një tabut. Kush ishte vallë? Kur kaluen afër meje, njanin prej tyne e njofta. Ma bani me sy. Manushin e vdekun, po e çojshin në shtëpi të dajës së tij. Vrapova mbas tyne. Nuk më bahej me e besue se nën atë batanije të vjetër, që i kishin hudhë përsipër, ishte Manushi, edukatori ynë, udhëheqësi ynë.

Nuk do ta harroj kurrë ditën e vorrimit. Po e lajshin në oborr trupin e gjakosun e të coptuem. Me lot ndër sy iu afrova,

Pjesa e sipërme e trupit ishte nxi e karbonizue prej korrentit elektrik. Tre gishta të dorës së djathtë i kishte të thyem e të prishun nga spicat dhe gozhdat. Ndër nejet e duerve, sa e thellë dukej vija e prangave dhe e telit me të cilin e kishin lidhë! Nën sqetulla kishte plagë të hapuna, kurse ndër trinat e kambëve, vrime të shpueme me gozhda. Në anën e majtë, ke zemra, kishte dy vende të çame me thikë, kurse afër zemrës dukej një gropë e mavijosun, e hapun nga bajoneta vdekjepruse. Dorën e djathtë e kishte mbledhë mbi plagë.

Mbasi e lanë kufomën dhe e vendosën në tabut, e përcuellën kah vorret e kodrave të Draçinit. Në vorrim ishin kushërijt e farë e fisi, fqinjët e disa njerëz të thjeshtë. Në qoshe të rrugëve kishte patulla të armatosuna. Anash kortezhit funebër shkojshin edhe disa njerëz me mustakë, me kapele të ndryshme e me duer ndër xhepa. Ishin njerëzit e xhandar-mërisë e të Gestapos, që, shikojshin porsu ujë, sa andej kënde, se mos zbulojshin ndonjë shok të Manushit.

Pesë a gjashtë dit mbas varimit të Manushit duel trakti i Komitetit Qarkor të Partisë kushtue dëshmorit Manush Alimani, ku midis të tjerash, thuhesh:

«Varrit të madh të martirëve të lirisë, iu shtue edhe një tjetër dëshmor. . .

Lajmi i zi, si vetë fytyra e vdekjes, u hap me shpejtësi rrufeje në qytetin tonë. MANUSH ALIMANI (MALI), një ndër shpirtëzuesit dhe udhëheqësit ma të mirë të krahinës së Shkodrës, u vra barbarisht nga Gestapoja gjermane. Mbi varrin e tij dhe të qindra dëshmorëve të tjerë, mbi hinin e shtëpijave të djeguna, mbi dhimbjen e zemrave të nanave, të grave e motrave të veshuna me të zeza, mbi lotët e fëmijëve të mbetun pa babë, neve — e me ne i gjith populli — betohemi se do të:

HAKMERREMI,

betohemi se do ta vazhdojmë luftën deri sa mos të ngelë kambë okupatori dhe gjurmë tradhëtari, derisa të sigurojmë Shqipninë e lirë, të pamvarun Demokratike-Popullore»¹⁾

Trakti për vdekjen e Manushit qarkulloi si vetëtimë nëpër qytetin tonë. Nanat patriote u veshën me të zeza. Nëpër bazat e Partisë, nëpër rrugët e rrugicat, ku kishte influencë lëvizja nacional-çlirimtare, flitej vetëm për Manushin.

Lajmi i vdekjes së Manushit u përhap në të gjitha lagjet e qytetit si dhe në malësitë e Shkodrës. Njoftimi i kësaj vdekjeje heroike mbërriti shpejt edhe në Tiranë, ku menjëherë Komiteti Qendror i Rinisë nxuer një trakt të posaçëm.

Për këtë, një komunist i vjetër tregon:

«.....Traktin e Komitetit Qendror të Rinisë për vdekjen e Manush Alimanit e ka shkruar vetë shoku Nako Spiru. Unë porsa mora vesh nga një korier prej Shkodrës vdekjen heroike të Manushit ja dëftova gëshejt menjëherë shokut Nako, i cili n'atë kohë strehohej në një bazë ilegale në Tiranë. Ai, kur muer veshit lajmin e hidhun, vrani vetllat. U duk se u pikëllue shumë. U ul në një tavolinë të vogël dhe në praninë time shkruajti traktin, të cilin ma dha për ta çue që të shtypej në një nga bazat e teknikës së Qarkorit të Tiranës.

Trakti u shtyp, u shumëfishue dhe menjëherë u dërgue në Shkodër e në qytete të tjera të Shqipnisë»²⁾.

1) A.M.P. i Shkodrës

2) A.M.P. i Shkodrës.

Vdekja e këtij biri të dashun të popullit i mbushi me urrejtje masat popullore. Ato u prekën thellë, por nuk e humbën besimin në fitore, përkundrazi vdekja e Manushit shtoi zemërimin e masave dhe forcoi urrejtjen e tyre kundër okupatorit e tradhëtarëve.

Fill mbas vdekjes së Manushit, poeti i ri revolucionar, Llazar Siliqi, në vjershën «Shokut MANUSH ALIMANI», shkruente:

.....
.....

**Manush, o hero, o luan,
Ndigjoje vajtimin, që sot
rinia e populli t'ban
me zjarr e me flakë, pa lot**

**Manush, udhëheqës rinije,
mbi trupin e yt të coptuem
betohemi se kem me ra flije
e shembullin tand me vijuem.**

**Përpara t'na prijë heroizmi
i shokut Manush Alimani,
t'luftohet, të shëmbet nazizmi,
t'çlirohet nga bisha vatani!**

.....
..... 1).

1) Botue në revistën ilegale «LIRI» — A.M.P. 3
Shkodrës.

Populli, tue ruejtë thellë në zemër kujtimin e
birit të vet të shtrejtë, thuri për Manushin kangën
e paharrueshme:

**Shkodra kreshnike, ti sot vajto
Manushin me shokë, heroj të tjerë kujto,
Manushin fashistët e vranë
dhe neve na lanë si djaln pa nanë.**

**Ç'po vijnë me trimni
Këto çetat partizane;
nga malet po zbresin,
qytetet i presin
Dridhuni, dridhuni,
Ju klika tradhtare!
Të vrapojmë, o shokë,
Hakun me ja marrë
Manushit me shokë
Dhe popullit shqiptar!
T'i zhdukim gjermanët
Dhe Ballin Kombëtar!**

Nuk kaluen veç 6 muej nga vdekja e tij heroike
dhe nga malet zbritën çetat, batalionet, brigadat e
divizionet e lavdishme partizane që, nën udhëheqjen
e Partisë, me në krye shokun Enver Hoxha, çliruen
Shkodrën dhe krejt Shqipninë, muerën hakun e Ma-
nushit me shokë dhe çuen në vend amanetin e shejtë
të mijra dëshmorëve të tjerë që ranë për Shqipninë
e bukur e të lirë.

Kanë kalue shumë vjet që kur Manushi u nda

prej nesh, por ende sot nuk më bahet me e besue se ai ka vdekë. Kaq të kjartë e kam fytyrën e tij, kaq afër e ndjej atë, sa më duket se, i buzëqeshun e optimist si gjithmonë, me gjoks përpara, marshon edhe ai me ne në atdheun tonë socialist.

PERMBAJTJA E LENDES

	Faqe
Kur trandafillat e lule-vilet	7
Dritat e shtëpisë nuk u fikën deri në mëngjes	9
Jetimi	10
Hartimi	11
Anëtar i rinisë komuniste	13
Manushi në Shkodër	16
Etja për dije	19
Si e njoha shokun Mali	21
Sekretari	23
Nji motor i vogël që s'pushonte as ditë as natë	30
2 maj 1944	32
1 vend-sun gjer në vdekje	39
29 maj 1944	42
Atë ditë	45

38742

SHKURTËKA E SHKËRTIT
SHKËRTIT

Redaktor: Gaqo Pisha
Korektor letrar: Neka Turkeshi
Kopertina: Ibrahim Shehu
Redaktor Teknik: Adem Lita

Tirazhi 4000 kopje Format 70x110/32 Stash: 2204-65

Shtyp N.I.S.: Shtypshkronjave «Mihal Duri» — Tiranë, 1966